URDHËR
Nr. 133, datë 7.4.2022

PËR SHFUQIZIMIN E URDHRIT NR. 372, DATË 11.6.2021, TË MINISTRIT TË DREJTËSISË, "PËR ZBATIMIN E MASAVE PËR PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË INFEKSIONIT TË SHKAKTUAR COVID-19 NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BURGJEVE DHE INSTITUCIONET E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar; nenit 9, të ligjit nr. 81/2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve"; nenit 5, pika 6, të ligjit nr. 80/2020, "Për Policinë e Burgjeve"; pikës 5 të urdhrit nr. 372, datë 11.6.2021, të ministrit të Drejtësisë, "Për zbatimin e masave për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19 në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale", të ndryshuar, me propozimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, përcjellë me shkresën nr. 3649 prot., datë 29.3.2022,

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e urdhrit nr. 372, datë 11.6.2021, të ministrit të Drejtësisë, "Për zbatimin e masave për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19 në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale", të ndryshuar.
2. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit në Ministrinë e Drejtësisë për njoftimin e këtij urdhri.
3. Ngarkohen drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, Sektori i Shëndetësisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe drejtuesit e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja